



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 575/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e organizatës së Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Hamdi Llulleci nga fshati Sllatinë e Madhe, komuna e Vitisë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET ankesa si e pabazuar e organizatës Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga organizata BIRN, ne te cilën pretendohet se më datë 12.12.2010, në orën 13:31 në fshatin Sllatinë e Madhe, komuna e Vitisë, në Qendrën e Votimit (QV) nr. 26070/02 dhe 2607, Hamdi LLulleci në cilësinë e komisionarit, “ka bërë me gisht të madh të dorës që e përdorin zakonisht simpatizantët e Partish Demokratike të Kosovës (PDK)”.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6 paragrafi 4 parasheh:

Panelet vendim-marrëse mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkak se nuk është ofruar dëshmi të mjaftueshme për të besuar se me date 12.12.2010, Hamdi Llulleci në cilësinë e komisarit në QV nr. 26070/02 dhe 2607, Sllatinë e Madhe- komuna e Vitisë, ka përdorur shenja apo gjeste të cilat i përkasin PKS-se. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 575/2010 më datën 15.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

